



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 15.09.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 14.09.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Vlera Pest Control SHPK" për aktivitetin: "Deratizimi i bodrumeve dhe garazhave publike si dhe rrjetit të kanalizimit në Komunën e Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -21-5725-211 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Vlera Pest Control SHPK" e datës 14.09.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Deratizimi i bodrumeve dhe garazhave publike si dhe rrjetit të kanalizimit në Komunën e Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -21-5725-211 kundër *Njoftimit për Kontrate të AK-se të datës 25.08.2021 dhe Njoftimit për korrigjimin e gabimeve të datës 30.08.2021, të publikuar në Platformën E Prokurimi.*

1. Vërtetohet *Njoftimi për kontrate i Autoritetit Kontraktues të datës 25.08.2021 si dhe Njoftimi për korrigjimin e gabimeve të datës 30.08.2021 dhe AK-ja vazhdon aktivitetin sipas të njëjtave publikime;*
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Arber Rexha BI" me datë 14.09.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Deratizimi i bodrumeve dhe garazhave publike si dhe rrjetit të kanalizimit në Komunën e Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -21-5725-211.

Autoriteti Kontraktues, me datë 15.09.2021 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi juaj është se Autoriteti Kontraktues ka vendosur kritere përjashtuese dhe lidhur me këtë ju sqarojme si vijon:

1. Pretendimi lidhur me kërkesa për çertifikatat nga kompanitë e akredituara është e pa bazuar, pasi që ekspertët tane dhe ata të jashtëm kanë konstatuar se në treg ka kompani të pa

licencuara dhe të pa akredituara që lëshojnë çertifikata dhe kërkesa jonë ka të bëjë pikërisht me krijimin e sigurisë për pranim të çertifikatave origjinale;

-Pretendimi tjetër se janë kërkuar shumë paisje-vetura poashtu është i pa bazuar, pasi që kemi të bëjmë me trajtimin e 220 kilometrave të kanalizimit dhe me sipërfaqe të bodrumeve prej 185,000.00 m² dhe trajtimi me kohë dhe në mënyrë efektive kushtëzon përdorimin e numrit më të madh të automjeteve. Këru nuk mund të bëhet fjalë për diskriminim pasi që përpos të drejtës për të formuar grup të OE-ik keni të drejtën edhe të shfrytëzimit të mjeteve të OE-ik tjerë (marrëveshje për shfrytëzim me qera apo ndonjë lloj tjetër);

-Pretendimi se është diskriminuese kërkesa që 60% e qarkullimit financiar dhe e vlerës së kontratave të realizuara të plotësohet nga lideri është e pa bazuar, pasi që Autoriteti Kontraktues lidhur me nivelin e kërkesave ka respektuar dispozitat ligjore sipas të cilave mund të kërkohet dyfishi i vlerës së parashikuar për qarkullim financiar dhe maksimumi 1,5 here për vlerën e kontratave të realizuara nga vlera e parashikuar, sepse nuk është tejkaluar me asnjërin kërkesë pragu ligjor. Pretendimi se eliminohen shumë OE-ik nuk qëndron pasi që është mundësia ligjore për formim të grupeve të OE-ik, ndërsa një arsye tjetër është se kemi të bëjmë me një aktivitet që duhet kryer në mënyrë shumë profesionale për të mos rrezikuar shëndetin e banorëve nga ndonjë epidemi, sidomos në këtë situatë kur jemi në rrezik të vazhdueshëm nga pandemia Virus 19. Pragu prej 60% për liderin e grupit është i lejuar edhe me pikën 27.4 të RRUOPP-së dhe aplikohet në këtë rast kryesisht për shkak të rrethanave aktuale me pandemi. Pretendimi se këtë kriter nuk e kemi përdorur në publikimet paraprake nuk qëndron pasi që në aktivitetin paraprak kjo kërkesë ka qëndruar vazhdimisht në të gjitha Njoftimet për korigjim, përpos korigjimeve të datës 05.05.2021 dhe 11.05.2021, por edhe në ato raste ka pasë reagime të OE-ik të interesuar për pjesëmarrje.

Nga sqarimet paraprake kuptohet qartë se kërkesat janë plotësisht të ligjshme dhe pretendimet tuaja të pa bazuara.

Bazuar në sqarimet e dhëna për pretendimet tuaja u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimin të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

